

AKT- THEMELIMI
I
SHOQERISE "Aurora Konstruksion" Sh.p.k

Personat qe firmosin me poshte :

1. Valbona JAULLARI

e bija e Shkelqimit lindur ne 05.10.1965
ne Tirane,banues ne rrugen "Arkitekt
Kasemi" pallati nr 1 Ap 25 me leter
Njoftim

2. Astrit HAXHIU

i biri i Muharremit lindur ne 16.11.1957
ne Çorovode te Skraparit banues ne rrugen
"Mihal Grameno" pallati 11/1 Ap 2 Tirane
me leter njoftim

3. Sabri KEÇO

i biri Hajdarit lindur me 02.09.1955 ne
Korçe ne rrugen "Hasim Vokshi" AP 9
Tirane me leter njoftimi nr

Kane hartuar si me poshte kontarten e themelimit te nje shoqerie me
pergjegjesi te kufizuar te cilen jane marre veshe te themelojne ndermjet tyre.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me
legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerishte me Ligjin nr 7638, date
19.11.1992 "Per shoqerine tregetare", Ligjin nr 7667, date 28.01.1993 "Per
regjistrimin tregtare" si dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate
veprimatrise se shoqerise, si dhe dispozitat e statutit te shoqerise qe i
bashkangjitet aktit themelues.

Emri i shoqerise eshte "Aurora Konstruksion" Sh.p.k

**Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen rruga "Bulevardi Deshmoret
e Kombit" pallati pran Fakultetit te Shkencave.**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetë:

Veprimitari ndertimi e montimi te cfardo lloji qofshin ato, civile , industriale
apo bujqesore, ndertime linja elektrike , hidraulike ujsjellsa, kanalizime,
truge, ura, tunele e restaurime.

Kryerja e cdo lloj operacioni dhe trsaksiioni ne lidhje me importimin , eksportimin, prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem ushqimor,industrial, bujqesor e blektoral.

Per aritjen e qellimit te mesiperm shoqeria ka te drejte te zhvilloj cfardo lloj aktiviteti industrial tregtare dhe financiar ,dhenien e garancive te cdo lloj natyre per detyrime te shoqerise ose te te treteve, te disponoj cfardo lloj license te marre pjesa ne cfardo lloj shoqerie qe zhvillon aktivitete te njejt apo te ndryshem me te.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital perbehet nga kontributet e meposhteme:

1. Z. Valbona Jaupllari kontribon me shumen 80.000 leke
2. Z. Astrit Haxhiu kontribon me shumen 10.000 leke
3. Z. Sabri Keço kontribon me shumen 10.000 leke

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjesa plotesishte te shlyera me vlore 1000 leke sejcila te rendituar simbas numrit te serise nga 1 deri ne 100.

Ne baze te kontributeve te larteppermendura:

1. Z. Valbona Jaupllari merr 80 pjesa te kapitalit themeltar te renditura nga numri 1 deri ne numrin 80 te serise.
2. Z. Astrit Haxhiu merr 10 pjesa te kapitalit themeltar te renditura nga nr 81 te nr 90 te serise.
4. Z. Sabri Keco merr 10 pjesa te kapitalit themeltar te renditura nga nr 91 deri ne nr 100 te serise.

Te gjithe pjeset e kapitalit themeltar jane neneshkruar plotesishte dhe jane shperndare ndermjet ortakeve si me poshte :

Secili prej ortakeve te ardheshem ka derdhur te zoti Astrit Haxhiu shumen korispoduese te pjeseve te neneshkruara.

Shumat e mbledhura jane depozituar prej tij ne banke ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper.

Shuma e depozituar vertetohet me ane te certifikates te leshuar nga kjo banke ne te cilen shenohen emrat dhe mbiemrat e ortakeve te ardheshem

pjeset e kapitalit themeltar te neneneshkruara dhe shuma e derdhur nga secili prej tyre.

Personat qe firmosin kete kontrate pasi kane marre dieni per kete certifikate, nje kopje ekzakte e se ciles ju eshte paraqituer atyre, deklarojne se shumat e dendhura prej tyre jane ne perputhje me ate qe shenohet ne certifikate dhe se ata konfirmojne nenshkrimet e pjesave te kapitalit themeltar ne perputhje me shumat respektive te dendhura.

Shoqeria do te administrohet nga nje administratore i vetem.

Administratori i pare i emeruar eshte z. Astrit Haxhiu me nje mandat 5 vjecar dhe me te drejte rizgjedhje.

Z. Astrit Haxhiu i jepen te gjitha kopetencat, te cilat ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.


Ai eshte i autorizuar te veproj ne emer te shoqerise qe krijohet deri ne regjistrimin e saj ne gjykate, vecanerishte ai eshte i paisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer te shoqerise te cilat i kalojne shoqerise qe nga momenti i regjistrimit.

Pervec te tjerave administratori eshte i ngarkuar per te kryer akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise dhe kopetencat e tij.

Pasi te behet miratimi i shoqerise keto akte dhe angazhime i neneshtrohen miratimit te bashkesise se ortakeve, jo me vone se nga data e mbledhjes se asamblese qe shqyrton dhe vendose mbi llogarite e vitit te pare finanziar.

Ky miratim bene automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te shoqerise.

Kjo kontrate themeluese eshte hartuar ne Tirane me daten 03.03.2008 me pese ekzemplare orgjinal.

ORTAKET Valbona JAUPLLARI	
Astrit HAXHIU	
Sabri KEÇO	